



**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Kuvendi – Skupština – Assembly**

Komisioni për Shërbime Publike,  
Administratë Lokale dhe Media  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.  
19.02.2008, ora: 11:00, N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajšhori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buqinca, Hajdin Abazi, Anita Morina, Rasim Selmanaj, Synavere Rysha, ndërsa munguan : Melihate Tërmkollli, Ali Lajçi dhe Radmila Vujovic.

Në mbledhje ishin të ftuar : Përfaqësuesi i TV-Mitrovica, Shefja ekzekutive e KPM-së, përfaqësuesja e AMPEK-ut.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Morina në cilësinë e zyrtareve ligjore dhe Mirjeta Heta, asistente administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajšhori, kryetar i Komisionit, me këtë:

**Rend dite:**

- 1. Shqyrtimi i shkresës së TV- Mitrovica.**
- 2. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Ad-Hoc Parlamentar për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, të dt. 12.11.2007.**

**Pika e parë e rendit të ditës**

**Esat Brajšhori** - duke i njoftuar anëtarët e komisionit se kjo pikë e rendit të ditës po shqyrtohet me shkresën e TV Mitrovicës adresuar komisionit, fjalën ia dha drejtorit të TV-Mitrovicës.

**Nexhmedin Spahiu** – përfaqësues i TV-Mitrovica - njoftoi Komisionin për shkeljet ligjore që janë bërë me mbylljen e TV-Mitrovicës nga shefja ekzekutive e KPM-së.

Mbyllja e TV- Mitrovicës nga ana e sheshe ekzekutive është një shkelje ligjore dhe tejkalim i kompetencave së kësaj zyreje, sipas Ligjit për KPM-në vendimet i merr Këshilli e jo shefja ekzekutive.

KPM-ja që nga dita e hyrjes së Ligjit në fuqi për KPM-në ende nuk ka licencuar TV kabllorë si më profitabile në Kosovë, të cilat i shkaktojnë buxhetit të Kosovës dëme të mëdha duke mos paguar taksa. Mbyllja e TV-Mitrovicës nga kjo zyre është bërë me qëllim që të arsyetohen dështimet e vet KPM-së.

Sipas nenit 20 të Ligjit të KPM-së parashihen sanksionet të cilat ekzekutohen pas vërejtjeve të shqyrtuara, korigjimeve, gjobave, pezullimit të licencës etj.

KPM-ja me datë 24.12.2007 i ka dërguar TV-Mitrovicës njoftimin për shkelje të cilin TV-Mitrovica e ka pranuar me 26.12.2007, me të cilin njoftim ekzekutohet urdhri për mbyllje, ku shefja ekzekutive me ndihmën e pjesëtarëve të SHPK-së ka konfiskuar pajisjet duke u thirrur në një vendim të Bordit të Ankesave për Media (BAM), i cili vendim është nxjerr si vendim kondicional.

Vlen për tu theksuar se në njoftimin me të cilin është ekzekutuar urdhri për mbylljen e TV-Mitrovicës nuk parashihet e drejta për tu ankuar.

TV-Mitrovica është licencuar në vitin 2001 si TV lokale, në vitin 2003 TV- Mitrovica ka marrë licencë për shtrirje më të gjerë të frekuencave nga Komisionerja e atëhershme e Mediave. Me ardhjen e Komisionerit të ri të Mediave kjo licencë është kufizuar me një vendim ku TV- Mitrovicës i ndalohet të ketë interferenca në Prishtinë dhe ne si medium e kemi kundërshtuar vendimin duke parashtruar ankesë Bordit të Mediave, i cili Bord ka marrë vendim për formimin e një komisioni teknik i cili do të vërtetonte vendimin e Komisionerit. Ai komision ka urdhëruar që TV- Mitrovica ti sjellë pajisjet sipas licencës d.m.th. rregullimin e sistemit të antenave.

Mirëpo, nga konfiguracioni i terrenit dhe mendimi i ekspertëve nuk ka qenë e mundur që të mos ketë interferenca në Prishtinë, pasi që antena ishte e vendosur në Cërnushë, ku në të njëjtin vend ishte vendosur edhe antena e ish- RTP-së, KTTN-së, shtylla e UNHCR UNMIK-ut dhe antena e IPKO-s.

Pastaj, kemi informuar shefen ekzekutive për vendosjen, rregullimin e antenave duke prezantuar dokumentin e nevojshëm dhe pagesën.

Konsiderojmë, tha ai, se urdhri për mbylljen e TV-Mitrovicës është vendim i një individi, dhe duke qenë Këshilli i KPM-së është jofunksional për shkak të mos zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, shefja ekzekutive i ka dhënë vetes të drejtë për marrjen e vendimeve kapitale.

Kufizimi i një mediumi televiziv është një shkelje e të drejtave të njeriut e sidomos duke pasur parasysh situatën në të cilën Mitrovica ndodhet para statusit të Kosovës.

Situata ka mundur të zgjidhet me një vullnet të mirë mbi bazën e përkrahjes që gëzon TV- Mitrovica në mesin e shoqërisë civile dhe spektrit politik.

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së - duke konfirmuar se ka ushtruar funksionin sipas detyrës zyrtare, i njoftoi anëtarët e komisionit se Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) si institucion i pavarur, i themeluar me Ligjin për KPM-në, është i vetmi autoritet në territorin e Kosovës që të menaxhojë spektrin frekuencor për rregullimin e mediave transmetuese. Ajo sqaroi se, Këshilli i KPM-së ka nxjerr një vendim me të cilin ia ka deleguar përgjegjësitë sheshe ekzekutive për ekzekutimin e vendimeve të Këshillit, dhe

zyra e shefit ekzekutiv ka autoritet sipas Ligjit për KPM-në të ndërmarrë masa ndaj transmetuesve ilegal.

Në vitin 2005 TV-Mitrovicës iu është dhënë licenca me mundësi zgjerimi, me të cilën licencë është ç'fuqizuar licenca e mëhershme dhe ne si institucion i referohemi licencës së vitit 2005. Pas disa muajsh është vërejtur se licenca nuk është respektuar dhe kemi filluar me ndërmarrjen e masave.

Ndryshimet e ofruara nga TV- Mitrovica për sjelljen e antenave në pajtueshmëri nuk kanë qenë valide dhe ne kemi qenë të obliguar të vazhdojmë me procedura të mëtutjeshme që konsistojnë në konfiskimin e antenave.

Në fund, konfirmoi se Komisionit Parlamentar për Media do ti prezantohen dokumentet se çdo veprim është ndërmarrë në baza ligjore, ndërsa punën e KPM-së do ta pasqyrojmë në Raportin vjetor që do ti dërgohet Kuvendit në fund të muajit shkurt.

Pas dëgjimit të të ftuarve, anëtarët e komisionit filluan me parashtrimin e pyetjeve:

**Fehmi Mujota** – pyeti se a ka parashtruar ankesë TV – Mitrovica në Gjykatë Supreme duke shfrytëzuar të drejtën ligjore?

**Nexhmedin Spahiu** – përfaqësues i TV-Mitrovica - nuk kam parashtruar ankesë, ne i kemi ofruar Bordit faktet tona për sjelljen e antenave në pajtueshmëri me licencën, vlerësimin e të cilave fakte, sipas Ligjit, duhej ta bënte Këshilli e jo shefja ekzekutive. Duke iu referuar Ligjit ai tha, se sipas cilës dispozitë ligjore Këshilli i delegon kompetencat tek shefja ekzekutive.

**Gani Buçinca** – pyeti shefen ekzekutive të KPM-së, se në bazë të cilës dispozitë ligjore Këshilli ka deleguar kompetenca tek shefja ekzekutive, duke kërkuar procesverbal në të cilin shihet se Këshilli ka marrë vendim për delegimin e këtyre përgjegjësive tek shefja ekzekutive?

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së – vendimin për delegimin e kompetencave Këshilli e ka nxjerr me qëllim të efikasitetit të punës së komisionit në përgjithësi.

**Gani Buçinca** – pyeti shefen ekzekutive:

- Si mund që dispozitat ligjore të shkelen për shkak të efikasitetit të punës së një institucioni?
- Si keni mundur të merrni një vendim subjektiv dhe arbitrar duke besuar vetëm në ekspertizën e një komisioni, pa e dëgjuar edhe ekspertizën e palës së dëmtuar?

Pyetje për TV- Mitrovicën:

- a ka mundur të jetë veprimtaria e juaj politike konflikt interesi me mediumet që keni udhëheq dhe këto kanë influencuar që ju të keni qenë si shënjestër në TV-Mitrovicë?

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së - u përgjigj, se ekspertiza është bërë sipas kërkesës së TV-Mitrovicës, të cilën kërkesë Bordi e ka aprovuar dhe ekspertët kanë hartuar raportet e tyre.

**Nexhmedin Spahiu** – përfaqësues i TV-Mitrovica - u përgjigj, jo, duke konfirmuar se ka vepruar konform vendimit të Bordit. Sipas tij vendimi ka qenë kushtëzues sipas së cilit nuk thuhet se TV-Mitrovica e humb licencën me 1 maj 2007, por thuhet se - **nëse** nuk i ofron faktet.

Ai pastaj, prezantoi kërkesën që ia kishte adresuar Këshillit e cila nuk është renditur si pikë e rendit të ditës nga shefja ekzekutive.

**Anita Morina** – kërkoi që TV – Mitrovica të paraqet dëshmi se janë bërë shkelje nga KPM-ja?

**Hajdin Abazi** – pyeti KPM-në:

- a ka raste të ngjashme kur nuk përmbushen kushtet e licencës dhe çfarë masa keni ndërmarrë
- a jeni të vetëdijshëm për pasojat që janë shkaktuar me mbylljen e TV-Mitrovicës dhe kërkoi sqarime për vlerësimet e ekspertëve lidhur me ekspertizat për mundësitë teknike dhe teorike të interferencave?

**Rasim Selmanaj** - a ka mundësi ligjore që TV-Mitrovica përsëri të veprojë si medium apo janë shterur mundësitë ligjore?

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së - u përgjigj, se me konfiskimin e antenave rasti është i mbyllur.

**Esat Brajshori** – pyeti KPM-në:

- A keni pozicion korrekt ligjor përballë të gjitha medimeve ndaj atyre që nuk kanë mbulueshmëri të mjaftueshme dhe atyre që kanë shtrirje të tejkaluar të frekuencave?
- Cili është dëmi që TV-Mitrovica i ka shkaktuar popullatës dhe mediave përveç që ka tejkaluar hapësirën e antenave sipas licencës, në kontekst të kësaj, çfarë masa keni ndërmarrë për RTK-në lidhur me mos shtrirjen e frekuencave në vendet ku banojnë minoritetet, pasi që kemi informatë se kjo pjesë e komunitetit paguan taksë për RTK-në por nuk kanë shikueshmëri?

**Fehmi Mujota** – pyeti KPM-në, a ka qenë Këshilli në përbërje të plotë për të marrë vendim për publikimin e tenderit për hapjen e TV-Mitrovicës, meqë Kuvendi ende nuk ka përfunduar procedurën për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të KPM-së?

**Përfaqësuesja e OSCE – departamenti për Media** – Ne, si OSCE, jemi të befasuar që ky Komision Parlamentar po debaton për një medium e jo për një gjendje të përgjithshme, kur dihet që në Kosovë ka 113 medime. Nga ana e OSCE-së nuk ka pasur arsye për intervenim gjatë punës së KPM-së dhe korrektësisë së tij. Të gjitha vendimet janë marrë në baza ligjore, sipas rregullave të KPM-së.

Lidhur me këtë ajo pyeti: Sipas cilave kritere Komisioni ka vendos ta thërret një mbledhje për të debatuar për një medium duke ditur se vendimet e Bordit të Ankesave për Media – BAM janë definitive.

Nëse ndonjë palë mendon se iu janë bërë shkelje ligjore, ajo ka të drejtë ti drejtohet gjyqit.

Mendoj, tha ajo, se duhet respektuar fuqinë argumentuese të legjislacionit ekzistues.

**Ardita Zejnullahu** – përfaqësuesja e AMPEK-ut – ajo konsideroi, se Këshilli i ka ikur obligimeve të veta duke ia hedh fajin zyrës së shefes ekzekutive. Fakti që vendimi i Bordit nuk ka qenë decidiv kjo lenë hapësirë për interpretim. Përderisa TV – Mitrovica dëshmon se ka realizuar faktet, ndërsa zyra e shefes ekzekutive e mohon një gjë të tillë, ajo tha se nuk është bërë ballafaqimi i fakteve nga komisionet vlerësuese, të cilën gjë është dashur ta bëjë Këshilli. Në mbledhjen e Këshillit të mbajtur në nëntor, është diskutuar kjo çështje që më tepër ka qenë një debat në mes të shefes ekzekutive dhe TV – Mitrovicës, në atë mbledhje anëtarët e Këshillit duke mos dashur të merren me çështjen iu drejtuan shefes ekzekutive duke i thënë, pse kjo çështje po shtrohet sot, edhe pse Këshilli kishte marrë qëndrim që çështja të shtrohej në një mbledhje, në mbledhjen e fundit Këshilli vendosi të shpall tender dhe në pauzën e mbledhjes, anëtarët e Këshillit iu drejtuan përfaqësuesit të TV-Mitrovicës duke i thënë “paditeni shefen ekzekutive”. Është e qartë se TV – Mitrovica ka tejkalluar mbulueshmërinë, por shumica e TV lokale i tejkalojnë kriteret e përcaktuara me licencë, qoftë për shkak të konfiguracionit apo terrenit.

Ajo theksoi, se duhet të evitohet në mënyrë decisive aplikimi i standardeve të dyfishta (d.m.th. jo dikujt ti shtyhen afatet e regjistrimit e të licencës e dikujt ti merret licenca). Edhe pse i është ofruar një fleksibilitet disa mujor TV-Mitrovicës, ne si AMPEK, kemi potencuar se duhet të merret një marrëveshje konsensuale dhe të mos shkohet me masa drastike për aq më tepër që në momentet në të cilat ndodhemi, TV – Mitrovica nuk ka televizion.

Në këtë kontekst ajo pyeti KPM-në: pasi është shpallur tenderi për TV - Mitrovicë si do të mund të vendos Këshilli lidhur me tenderin kur ky Këshill tani ka vetëm tre anëtarë e katër të tjerë ende nuk dihet se kur do të emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

**Gani Buçinca** – pyeti KPM-në: A keni ndërmarrë masa ndaj TV – Iliria, i cili medium ka shikueshmëri në Prishtinë, apo masat i ndërmerrni në mënyrë selektive si p.sh për TV-Mitrovicën?

**Hajdin Abazi** – pyeti:

- A ka pasur ndonjë ankesë prej medimeve tjera, për të kuptuar se Bordi i Ankesave për Media ka marrë çështjen e TV-Mitrovicës për shqyrtim sipas kërkesës,
- A veproni njëjtë edhe për TV tjera apo vetëm për TV-Mitrovicën keni marrë vendim si rast flagrant?

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së - - ajo tha, se zyra e shefit ekzekutiv vetëm e ka ekzekutuar vendimin.

**Synavere Rysha** - KPM-ja për 3 vite nuk ka licencuar TV kabllorë të kësaj ajo pyeti:

- Sa i ka shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës mos licencimi i TV kabllorë,

- Cili ka qenë prioriteti i KPM-së: mbyllja e TV – Mitrovicës apo licencimi i TV kabllorë?

**Naile Selimaj** – Shefe Ekzekutive e KPM-së – në prill të vitit 2006, Këshilli i KPM-së ka draftuar rregulloren për TV kabllorë dhe taksat e licencimit, e cila rregullore ka hyrë në fuqi me 6 korrik 2006, sipas kësaj rregulloreje KPM-ja ka filluar të bëjë regjistrimin e TV kabllorë, mirëpo jemi në fazën e respektimit të afateve pasi që një TV kabllor ka ushtruar ankesë lidhur me taksën e licencës.

**Mufail Bytyqi** – Përfaqësues i Rrjetit të TV rajonale të Kosovës – ai tha, se vendimi është i nxituar. Organi drejtues i rrjetit të TV rajonale ka kërkuar nga KPM-ja që të shqyrtojë rastin e TV – Mitrovicës me faktin se nuk është e vetmja shkelje në Kosovë. Nëse ne jemi ata që proceset do ti qojmë përpara nuk guxojmë të bëjmë gabime të tilla dhe po qe se dojmë ti ndihmojmë proceset pozitive në shoqëri, me shkelje të tilla të përsëritura ne vetes po i minimizojmë perspektivën.

Pas përfundimit të debatit Kryetari i Komisionit,

**Esat Brajshori** – propozoi që palët ti prezantojnë dëshmitë e tyre në mënyrë që komisioni në mbledhjen e radhës të nxjerr konkluzion.

**Pika e dytë e rendit të ditës –**

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media në mbledhjen e mbajtur me 19.02.2008, shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit Ad-Hoc Parlamentar për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, të datës 12.11.07, nr. 02.3929, pas shqyrtimit, vendosi që Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ti drejtohet me:

## **KËRKESË**

Për radhitje dhe shqyrtim në rend dite të Rekomandimit të Komisionit Ad-Hoc Parlamentar për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

### Arsyetim

Komisioni Ad-Hoc Parlamentar për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, në mbledhjen e mbajtur me datë 9 nëntor 2007, ka përzgjedhur dy nga katër të propozuarit për emërim të anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe ka nxjerr rekomandim që Kuvendit të Kosovës ti propozojë emërimin e dy anëtarëve të përzgjedhur.

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media në mbledhjen e mbajtur me datë 19.02.2008, ka shqyrtuar shkresën e Komisionit të Pavarur për Media adresuar Komisionit Parlamentar si komision funksional, në të cilën shkresë Komisioni i Pavarur për Media në mungesë të anëtarëve të Këshillit të Mediave, të cilët duhet ti emërojë Kuvendi i Kosovës, nuk do të mund të përmbush objektivat dhe prioritetet si institucion i pavarur.

Sipas, Komisionit të Pavarur për Media kjo çështje është urgjente, sepse mungesa e kuorumit të anëtarëve të Këshillit, ndikon në mosfunksionimin e punës së KPM-së.

Kryetari i Komisionit:

Esat Brajshori